REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PRRENJAS

Nr.735 prot. Prrenjas, më 28.03.2025

URDHËR

Nr.121, datë 28/03/2025

"PËR VENDOSJEN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE DHE VENDET E AFISHIMIT GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE"

Në mbështetje të nenit 8, nenit 9, nenit 64 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", nenit 79 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar, Ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

URDHËROJ:

1. Pranë zyrave dhe ambienteve të çdo Njësie Administrative të Bashkisë Prrenjas të kryhet afishimi i materialeve edukative zgjedhore, në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën zgjedhore të një subjekti të caktuar zgjedhor.
2. Në vendet e afishimit të përcaktuara sipas pikës 1, subjektet zgjedhore lejohen të afishojnë vetëm materiale të programeve të tyre zgjedhore.
3. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore lejohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore statike në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor.
4. Të gjithë subjektet zgjedhore duhet të japin informacion për adresat e sakta të zyrave elektorale dhe brenda 5 ditëve pas marrjes së informacionit nga subjektet zgjedhore të bëhet verifikimi i vendodhjes së tyre dhe respektimi i dispozitave të Udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 "Për përdorimin e materialeve

propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

5. Policia Bashkiake merr masa të menjëhershme për heqjen e materialeve propagandistike të afishuara dhe të vendosuara në kundërshtim me këtë urdhër dhe me kriteret e përcaktuara në udhëzimin përkatës të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.
6. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit dhe e Pronës, Policia Bashkiake, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

NURI BELBA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËS KRYETARI I BASHKISË

AUREL KARRIQI